



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AKADEMIA E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 354/15 Prot.

Tiranë më, 10/11/2021

**VENDIM**

**Nr. 24, datë 10.11.2021**

**“Për caktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të Senatit Akademik të ASA-së”**

Në bazë të nenit 49, pika 1 e ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 8 dhe 10 të ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999, “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe të Vendimit nr. 656, datë 31.10.2018 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të përhershme të njëjësive të qeverisjes qendrore”, Bordi i Administrimit

**VENDOSI**

1. Masa e shpërblimit mujor të çdo anëtari të Senatit Akademik të jetë 25.000 lekë në muaj, pavarësisht numrit të mbledhjeve që do të zhvillohen gjatë një muaji.
2. Vendimi nr. 10, datë 21.12.2018 “Për caktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të Senatit Akademik të ASA” revokohet.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Zyra e Financës dhe Sekretarja teknike.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT**

**EMIS ÇERAVA**

